

## KOMPOZITAT NË ROMANIN 'BIJTË E ASKUJT 1, 2'

Shkelqim MILLAKU

Fakulteti i Filologjisë, Prizren  
[shkelqim.millaku@uni-prizren.com](mailto:shkelqim.millaku@uni-prizren.com)

## Abstrakti

Fjalët e përbëra të shqipes janë të ndryshme dhe janë pasqyruar relativisht vonë në gramatikat e gjuhës shqipe. Ato kanë filluar nga mesi i shekullit XIX duke kaluar përmes dy rrymave: Në rrymën e parë hynë autorët e huaj, si: *Hahni, Dozoni, Weigandi* e ndonjë tjetër, të cilët e mohojnë plotësisht ekzistimin e kompozitave të mirëfillta të shqipes, kurse nga ana tjetër (rryma e dytë), dashamirët e gjuhës shqipe, të cilët u mbështetën në gjuhën popullore të shqipes dhanë një pasqyrim objektiv të fjalëve të përbëra. Si themelvënës të një tradite të tillë janë gramatikanët: *K. Kristoforidhi, S. Frashëri, N. Frashëri, K. Cipo* e ndonjë tjetër.

Në përgjithësi në korpusin e Rexhep Qosjes dhe në veçanti në romanet e tij kemi evidencuar mjaft kompozita të llojeve të ndryshme, të cilat janë në përdorim dhe të sistemuara, mirëpo kemi edhe fjalë të reja, apo kompozita që nuk janë në FEGjSh dhe si të tilla e pasurojnë gjuhën. Formimet e tyre janë: *këpujore - bashkërenditëse, përcaktuese - nënrenditëse*, të tipit të përzier kompozitë + ndajshim, pastaj kompozitat dëshirore, urdhërore, sinonimike, antonimike, kompozita me shkurtesa e ndonjë tip e nëntip tjetër që janë evidencuar dhe prodhimtare në krijimtarinë e Qosjes. Disa nga fjalët e përbëra janë: *Bashkëdyzim, bojëhiri, bojëqielli, duarshtrenguar, emërvend, fulqinjgjerë, gjysmëmaturë, kult-filmin, puthakëmbës, Qosja-Kadare, shqiptare-turke-iraniane, vendzbulimeve, radio-shërbëtorët, atëherë-shkrimtarët, ballukedjathtas, ballukedrejtë, ballukegjatë, bashkëkëngëtar, bashkim-vëllazërim, bojëbalte, bojëbari, bojëgruri, bojëhiri, bojëqielli, brekëshqyer, bukurpajtuar, buzëdredhur, buzërrudhur, buzëvrenjtur* etj.

*Fjalët kyçe:* Rexhep Qosja, kompozitat, duargjatë, duarlirë, duarpaluar, duarshtrenguar, duarshtirë.

Trajtimi, studimi dhe përdorimi i kompozitës është një art në vete, sepse përbërja e saj ka mundësi reale për ta ekonomizuar kodifikimin dhe përdorimin e gjuhës, prandaj si në aspektin semantiko-leksikor, ashtu edhe në atë morfo-sintaksor ka hapësirë për t'i studiuar fjalët e përbëra.

Në përgjithësi në korpusin e Rexhep Qosjes dhe në veçanti në romanet e tij, në këtë rast në romanin 'Bijtë e askujt 1, 2' kemi evidencuar mjaft kompozita të llojeve të ndryshme, të cilat janë në përdorim dhe të sistemuara, mirëpo kemi edhe fjalë të reja, apo kompozita që nuk janë në FEGjSh dhe si të tilla e pasurojnë gjuhën. Formimet e tyre janë të mundshme për të qenë: *këpujore - bashkërenditëse, përcaktuese - nënrenditëse*, të tipit të përzier kompozitë + ndajshim, pastaj kompozitat dëshirore, urdhërore, sinonimike, antonimike, kompozita me shkurtesa e ndonjë tip e nëntip tjetër që janë dëshmuar dhe prodhimtare në romanet dhe në krijimtarinë e Qosjes. Disa nga fjalët e përbëra që janë përdorur në romanin 'Bijtë e askujt' janë: *Bashkëdyzim, bojëhiri, bojëqielli, duarshtrenguar, emërvend, fulqinjgjerë, gjysmëmaturë, kult-filmin, puthakëmbës, Qosja-Kadare, shqiptare-turke-iraniane, vendzbulimeve, radio-shërbëtorët, atëherë-shkrimtarët, ballukedjathtas, ballukedrejtë, ballukegjatë, bashkëkëngëtar, bashkim-vëllazërim, bojëbalte, bojëbari, bojëgruri, bojëhiri, bojëqielli, brekëshqyer, bukurpajtuar, buzëdredhur, buzërrudhur, buzëvrenjtur* etj.

Shqipja sikur edhe gjuhët e tjera mund të pasurohet me fjalë të reja përmes disa burimeve dhe në veçanti përmes fjalëve të prejardhura dhe kompozitave. Studiuesit e gjuhës dhe shkrimtarët në veçanti e kanë një meritë të veçantë për ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës. Në këtë studim do t'i trajtojmë kompozitat e evidencuara në romanin 'Bijtë e askujt 1, 2'. Romani ka kompozita që janë të sistemuara në gjuhë, por ka edhe fjalë të përbëra që janë risi për pasurimin e gjuhës.

‘Në roman gjejmë një numër të madh fjalëkrijimesh, në të shumtën e herës, sipas gjedheve të njohura të fjalëformimit të shqipes, ndër të cilat mbizotërojnë ato me ndajshitesim e përngjitje. Autori shfrytëzon parashtesat, prapashtesat dhe sindajshitesat e burimit shqip, por edhe të burimit grek e latin: *syhaptësi, shtigëri, sipëri, paskajësi, shpërfolje, përhiqim, skajësisht, gjithëfuqi, jofuqi, jongjitëse, jokufitare, faqekuqërremtë, fulqinjgjerë, fulqinjngushtë, gjashtëgishtakë, mendjepakët, mendjevogël, passhuplakë, bojëtulle, vetërpur, mirëfilltësore, mirëgënjej, poshtëshkrime, mesarak, antiart, hereziark/ët, burgrafi, bizantinishte, myslimanofob* etj.

Në grupin e madh të këtyre formimeve shquajnë formimet librore – ekspresive, të cilat pasurojnë ndjeshëm gjuhën e sotme shqipe e ligjërimin dituror. Për ilustrim po sjellim disa nga këto formime: *puthadorës, puthakëmbës, heshtak, lajmsjellës, larghedhës, lartndershëm, lavdimadh, bashkëquhem, bashkëshkrimtar, tokësohem “aterroj”* etj. Në romane shquan përpjekja e autorit jo vetëm për të përdorur formime pak a shumë të njohura, por edhe të krijojë fjalë të reja nën ndikimin e strukturës poetike të fjalorit të shqipes. Në këtë grup përfshihen një numër i përfillshëm formimesh si këto: *fundbotshëm, gjithkundshëm, gjithmonshëm, heqkeqës, gjinjëvogël, bukurkuptimshëm, mezidukshëm, mezipritshëm, keqtingëllues, tingullkëndshme, kurnnatë, kurnajë, mirëfilltësore, mbrëmësore, vetmishte, i xhevahirtë* (Sh. Islamaj).

### Çfarë është kompozita?

Për t’u përgjigjur pyetjes në fjalë, ju ofrojmë pesë citime autoritare, të cilat e sqarojnë kuptimin dhe kërkesën e pyetjes:

1. Jani Thomaj për këtë çështje thotë: “*Kompozitë-a, -at. Fjalë të përbëra, janë të formuar nga bashkimi i dy e më shumë temave në procesin e krijimit të fjalëve të reja. Pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore si: zemërgur, belhollë, buzëqesh, keqkuptoj, fjalëshumë*”<sup>1</sup>.
2. Disa autorë që e kanë botuar *Gramatikën e gjuhës shqipe 1*, të cilët, për kompozitën e ka dhënë këtë mendim: “*Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi, me anë të cilës krijohen fjalë të reja, që kanë në përbërjen e tyre dy e më shumë tema motivuese, njëra nga këto (tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër është e asnjansuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore, p.sh. bregdet, botëkuptim, marrëdhënie, juglindje, veriperëndim, vendbanim, syzi, mësimor-edukativ (...)*”<sup>2</sup>.
3. Kompozitat janë trajtuar edhe nga A. Kostallari, i cili e ka paraqitur këtë mendim: “*Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëse që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një njësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohen semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintetike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj*”<sup>3</sup>.
4. Fjalët e përbëra janë të gjitha ato fjalë të bashkuara nga dy ose më shumë fjalë apo tema motivuese të thjeshta, të cilat bashkohen në një fjalë të vetme, ku në formimet e tyre gjejmë emra, mbiemra, folje e ndajfolje, por nuk mungojnë edhe rastet e tyre (fjalë e përbëra) me temë numërorësh dhe përemrash. Fjalët e përbëra janë të gjitha ato fjalë të bashkuara nga dy ose më shumë fjalë apo tema motivuese të thjeshta, të cilat bashkohen

<sup>1</sup> Jani Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, f. 90.


<sup>2</sup> Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 70.

<sup>3</sup> A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhë shqipe*; Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë 1972, f. 83.

në një fjalë të vetme, ku në formimet e tyre gjejmë emra, mbiemra, folje e ndajfolje, por nuk mungojnë edhe rastet e tyre (fjalë e përbëra) me temë numërorësh dhe përemrash<sup>4</sup>.

5. Sipas llojit të marrëdhënieve sintaksore midis gjymtyrëve, dallojmë kompozitat me marrëdhënie bashkërenditëse (këpujore) dhe nënrenditëse (përcaktore). Këto dy grupe, ndahen në nëngrupe si emra të përbërë, ku hyjnë *emër + emër*; *emër + mbiemër*; *emër + folje*; *emër + pjesore* e ndonjë nëntip tjetër, të cilat kanë dhënë apo krijuar edhe pjesë të tjera të ligjëratës. Në vazhdim e kemi studiuar dhe krahasuar tipin e kompozitave këpujore, të cilat përbëhen prej dy a më shumë gjymtyrësh me lidhje bashkërenditjeje ndërmjet tyre, si: *kult-filmin*, *Qosja-Kadare*, *shqiptare-turke-iraniane*, *radio-shërbëtorët*, *atëherë-shkrimtarët*, *bashkim-vëllazërim ose shembuj të tjerë nacional-socializmi*, *ekonomiko-shoqëror*, *verilindje*, *tekniko-shkencor*, *politiko-shoqëror*, *dritëhije* etj<sup>5</sup>. Andaj, studimi plotësohet me modelin e dytë të kompozitave përcaktore, të cilat përbëhen prej dy e më shumë gjymtyrësh dhe çdoherë njëra gjymtyrë e përcakton tjetrën, si: *bojëbalte*, *bojëbari*, *bojëgruri*, *bojëhiri*, *bojëqielli*, *brekëshqyer*, *bukurpajtuar*, *buzëdredhur*, *buzërrudhur*, *buzëvrenjtur* etj.

Në romanet e Rexhep Qosjes, '*Bijtë e askujt 1*' janë evidencuar 317 (këpujore e përcaktore), kurse në '*Bijtë e askujt 2*' janë evidencuar 392, pra gjithsej janë 794 kompozita (fjalë të përbëra), të cilat, si të tilla, përdorën në shoqëri, mirëpo edhe autori i ka përdorur. Në dy romanet në fjalë i kemi evidencuar **76 kompozita**, të cilat nuk janë në FESh dhe si të tilla janë prurje të reja, për pasurimin e fjalorëve dhe të gjuhës. Ky paragraf argumentohet si në figurinë e parë:



**Figura 1**

Në vazhdim do t'i analizojmë disa kompozita, të cilat e argumentojnë mënyrën e fjalëformimit, pra si kanë ardhur nga fjalët e parme në ato të përbëra. Kompozitat e përzgjedhura janë: *duarshtrënguar* (*emër + mbiemër*); *bojëqielli* (*emër + emër*); *kult-filmin* (*emër + emër*); *shumëgjuhësor* (*ndajfolje + mbiemër*); *vendzbulimeve* (*emër + emër*); *hane-dane*; *latino-amerikanët*; *leniniste-staliniste*; *lindore-perëndimore*; *myslimano-kristiane*; *mendjeshkurtra-flokëgjata* dhe ndonjë shembull tjetër që është gjeneruar në tabelën apo figurën e dytë.

<sup>4</sup> Shkelqim Millaku, *Kërkime gjuhësore 3*, Prishtinë, 2024, f. 96.

<sup>5</sup> Shkelqim Millaku, *Studime gjuhësore, 1*, Prishtinë, 2004, f. 13-14.






|                                                                                   |                                                                                   |                                                                                    |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Përbërja në aspektin morfologjik dhe gjenerues mund të jetë kjo <sup>6</sup> :    |                                                                                   |                                                                                    |                                                                                     |
| N + M = M <sup>7</sup> - Tetëdhjetëvjeçare                                        | N + E = E                                                                         | Bashkëmasturbuesit                                                                 |                                                                                     |
| E + E = E - Fundshtröjsë                                                          | E + E = E                                                                         | Shqiptar-turk                                                                      |                                                                                     |
| N + E = E - Dykahs                                                                | E + E = E                                                                         | Gjysmëromanin                                                                      |                                                                                     |
| N + E = E - Keqshkrues                                                            | N + M = E/M                                                                       | Kundërprindëror                                                                    |                                                                                     |
|  |  |  |  |
| Tetëdhjetëvjeçar<br>e                                                             | Gjysmëromani<br>n                                                                 | Kundërprindëror                                                                    | Keqshkrues                                                                          |

Fig. 2

Kompozitat apo fjalët e përbëra janë mundësi reale dhe e mirë për pasurimin e gjuhës. Në romanet e Rexhep Qosjes ka kompozita të llojeve të ndryshme, të cilat luajnë një rol të mirë në ekonomizimin e gjuhës dhe prej atyre ka që janë fjalë të reja, por edhe si të tilla e kanë brumëzuar e kuptimësuar veprën e autorit në fjalë. Studimi ynë, në këtë rast nuk e përfshinë



edhe aspektin kuptimor e sintaksor të tyre, sepse si studim i tillë do të ishte zgjeruar shumë, mirëpo shtrirja e studimit është vetëm në aspektin morfologjik, sepse fjalët e përbëra i bëjnë fjalitë ma ekonomike, të cilat mundësojnë dhe e reduktojnë mospërdorimin e fjalive të thjeshta, sintagmave, lokucioneve, apo njësive të ndryshme frazeologjike, por e kodifikojnë dhe e standardizojnë mesazhin kuptimor e logjik e gjuhësor. Disa nga shembullit e kompozitave që janë përdorur në romanin ‘Bijtë e askujt 1, 2’ janë: bashkëdyzim, bojëhiri, bojëqielli, duarshtrenguar, emërvend, fulqinjgjerë, gjysmëmaturë, kult-filmin, puthakëmbës, Qosja-Kadare, shqiptare-turke-iraniane, vendzbulimeve, radio-shërbëtorët, atëherë-shkrimtarët, ballukedjathtas, ballukedrejtë, ballukegjatë, bashkëkëngëtar, bashkim-vëllazërim, bojëbalte etj., të cilat, kur të zbërthehen, në shumicën e rasteve, si fjalë të parme ekzistojnë në fjalorë të ndryshëm, mirëpo bashkimi i tyre në dy apo më shumë fjalë kuptimore, në një të vetme kanë

krijuar mundësinë reale për formimin e një fjale të re, e cila si e tillë apo si të tilla, mund të jetë produkt i ri për shqipen, por edhe për ekonomizimin e gjuhës.

Në vazhdim i paraqesim vetëm kompozitat e reja, të cilat janë të dëshmuara në romanin ‘Bijtë e askujt 1, 2’, kështu që pas verifikimit të shumicës së tyre, ato nuk<sup>8</sup> janë në FESH dhe si të tilla janë të mirëseardhura për pasurimin e gjuhës. Kompozitat e përdorura në romanin në fjalë janë:

<sup>6</sup> Shkelqim Millaku, *Kërkime gjuhësore* 3, Prishtinë, 2024, f. 109.


<sup>7</sup> N - numëror; M = mbiemër; E – emër i përbërë; N – ndajfolje dhe shembujt e dhënë mund të jenë edhe fjalë polisemike.

<sup>8</sup> Një sqarim: 76 kompozita që janë në këtë punim, të cilat i konsideroj të reja për shqipen, në ndonjë studim me të thelluar ka mundësi reale që të ekzistojnë përdorimi i ndonjëres prej tyre, mirëpo në FESH dhe sipas kuptimësisë së përdorimit, si të tilla nuk janë.

Allajaponeze, allakineze, bashkëdyzim, bashkëkëngëtar, bojëhiri, bojëqielli, brekëshqyer, bukurkuptimshëm, doravetë, duarshtrenguar, dyrenmatit, emërvend, euroatlantike, evropiano-aziatik, flokëzezë, fulqinjgjerë, fulqinjngushtë, fundbotshëm, fytyrëmërrolur, fytyrëpërdredhuri, galapagosit, gjithëmëshirshmi, gjithëpopullor, gjysmëmaturë, gjysmëshqipërisë, hane-dane, kontrapunktit, krahëgjerë, kriptokomunist, *Kriptokomunist*, kryearkivisti, kryebashkiaku, kryeprogonistin, kult-filmin, kulturo-historike, kundërkombëtare, kuqërremta, lartnënshkruarit, latino-amerikanët, leniniste-staliniste, lindore-perëndimore, myslimano-kristiane, mendjepaktit, mendjeshkurtra-flokëgjata, mendjelartit, mirëfilltësorë, mezidukshëm, neoimperializëm, ngjyrëkuq, njëkombëtar, punisto-mafioze, puthakëmbës, Qosja-Kadare, quhetkasap, radio-shërbëtorët, rend-shoqëror, rrethfaqe, rrethkilogramësh, sahatkulla, sipërparaqitura, stërkequr, stërngopur, Superstradave, shqiptareturke-iraniane, shumëfytyrësh, shumëgjuhësor, shumëkend, shumëkontinentale, shumëkujt, humëndryshme, shumëpartiake, shumëvëllimshme, vendzbulimeve, vitlindja, zanatlinjve, zikëqijtë.

Për arsye të saktësisë shkencore, në vazhdim i listojmë kompozitat e reja që janë të përdorura në romanin *Bijtë e askujt 1, 2* dhe ato janë:

**allajaponeze:** *Dhe allakineze e allajaponeze.* (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f.186).



**allakineze:** *Dhe allakineze e allajaponeze.* (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 186).

**bashkëdyzim:** *...amerikan, i thotë Delina. Bashkëdyzim shpëtimtar. Bashkëdyzim shpëtimtar për shqiptarin (Bijtë I, 2010, f. 140) edhe në (Qosja, Bijtë II, 2010, f. 236, 320).*

**bashkëkëngëtar:** *...i vjetër, a shok shkolle, a bashkëkëngëtar (Bijtë I, 2010, f. 117).*

**bojëhiri:** *Rrobat bojëhiri. Këmisha e bardhë. (Bijtë I, 2010, f. 335).*

**bojëqielli:** *...bardhë ka/veshur këmishë bojëqielli të butë (Bijtë I, 2010, f. 145).*

**brekëshqyer:** *Kishte ardhur brekëshqyer, kurse tani, gati (Bijtë I, 2010, f. 14).*

**bukurkuptimshëm:** *...pse e ndërroi emrin e bukurkuptimshëm. (Bijtë I, 2010, f. 404).*

**doravetë** (*Bijtë I*, 2010, f. 314).

**duarshtrenguar:** *...dëgjuar, ka më së shumti duarshtrenguar dhe ta çoj (Bijtë I, 2010, f. 223).*

**dyrenmatit:** *...gjetur në dorë Fizikanët e Dyrenmatit... (Bijtë I, 2010, f. 38).*

**emërvend:** *Emërvend i bukur. (Bijtë I, 2010, f. 56).*

**euroatlantike:** *...Integrimet Euroatlantike! (Bijtë I, 2010, f. 131).*

**evropiano-aziatik:** *... më falni evropiano-aziatik. (Bijtë I, 2010, f. 100).*

**flokëzezë:** *Do të thotë flokëzezë, syzezë, vetullzezë. (Bijtë I, 2010, f. 373).*

**fulqinjgjerë:** *nëntëmbëdhjetë si veten: fulqinjgjerë. (Bijtë I, 2010, f. 135).*

**fulqinjngushtë:** *fulqinjgjerë dhe fulqinjngushtë! Pse s'thua. (Bijtë I, 2010, f. 135).*

**fundbotshëm:** *...të madh apo/pikëllim të fundbotshëm. Më së shpeshti. (Bijtë I, 2010, f. 7).*

**fytyrëmërrolur:** *...i përgjigjem sigurisht pak fytyrëmërrolur. (Qosja, Bijtë II, 2010, f. 77).*

**fytyrëpërdredhuri:** *Fytyrëpërdredhuri. Piramida! (Bijtë I, 2010, f. 198).*

**galapagosit:** *...më ngadalë se breshkat e Galapagosit, që e mbante (Qosja, Bijtë II, 2010, f. 188).*

**gjithëmëshirshmi:** *...shpallur të dënueshme nga i gjithëmëshirshmi i tyre. (Bijtë I, 2010, f. 345).*

**gjithëpopullor:** *Gëzimi ishte gjithëpopullor. (Bijtë I, 2010, f. 307).*

**gjysmëmaturë:** ...pasur shok shkolle deri në gjysmëmaturë/dhe, mandej. (Bijtë I, 2010, f. 400).

**gjysmëshqipërisë:** Gjysmëshqipërisë etnike... (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 106).

**hane-dane:** ...kjo hane-dane është çmuar. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 147).

**kombibus** të vjetër, kurse rreth një orë e gjysmë në qoftë se shkojmë. (Bijtë I, 2010, f. 241).

**kontrapunktit:** ...ai krijon efektin e kontrapunktit. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 342).

**krahëgjjerë:** ...Është kokëmadh dhe është krahëgjjerë. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 29).

**kriptokomunist:** Dreqi e di! KRIPTOKOMUNIST. (Bijtë I, 2010, f. 273);

**Kriptokomunist:** (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 33).

**kryearkivisti:** Më falni, thotë, kryearkivisti i Arkivit... (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 301).

**kryebashkiaku:**...duke shkuar në pritje te kryebashkiaku... (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 240).

**kryeprogonistin:** ...që ka vuajtur burg me kryeprogonistin. (Bijtë I, 2010, f. 384).

**kult-filmin:** Madje, ai kur flet për kult-filmin. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 337).

**kulturo-historike:** ... për monumentet kulturo-historike dhe fetare. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 123).

**kundërkombëtare:** ...është një thirrje kundërkombëtare. Heshtje. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 84).

**kuqërremta:** do të kenë qenë të kuqërremta. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 112).

**lartnënshkruarit:** si dhe prej të lartnënshkruarit. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 49).

**latino-amerikanët:** ...më mirë i ruajnë latino-amerikanët e lashtë. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 165).

**leniniste-staliniste:** ...ishin politikë dhe ideologji leniniste-staliniste. (Bijtë I, 2010, f. 267).

**lindore-perëndimore:** ...çervish identitetesh lindore-perëndimore. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 314).

**myslimano-kristiane:** lindore-perëndimore myslimano-kristiane. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 298, 299).

**mendjepaktit:** Vetminë s'e çmojnë mendjepaktit. Turma! (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 194).

**mendjeshkurtra-flokëgjata**

**mendjelartit:** mirëfilltësorë janë mendjelartit! (Bijtë I, 2010, f. 125).

**mirëfilltësorë:** mendjeveglit, kurse mirëfilltësorë janë. (Bijtë I, 2010, f. 125).

**mezidukshëm:** ...metra larg një guri të mezidukshëm. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 99).

**neoimperializëm:** ...e disa të tjerë neoimperializëm? (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 245).

**ngjyrëkuq:** ...sallat amerikane mbi tepihun ngjyrëkuq janë lëshuar. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 315).

**njëkombëtar:** ...si të thuhet njëetnik, njëkombëtar, që nu janë. (Bijtë I, 2010, f. 334).

**punisto-mafioze:** ...shumë e rrezikshme: aleanca punisto-mafioze! (Bijtë I, 2010, f. 382).

**puthakëmbës:** Është më saktë: puthakëmbës. (Bijtë I, 2010, f. 33, 201).

**Qosja-Kadare:** ...dikush polemikën Qosja-Kadare. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 335).

**quhetkasap:** me fjalë tjetër mund të quhetkasap! (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 140).

**radio-shërbëtorët:** ...gazeta, në televizione, në radio-shërbëtorët e tyre! (Bijtë I, 2010, f. 140).

**rend-shoqëror:** filozofi, politikë dhe rend-shoqëror. (Bijtë I, 2010, f. 363).

**rrethfaqe:** ...sjellë letërsisë shqipe rrethfaqe prozë. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 360).

**rrethkilogramësh:** i plotë, mund të jetë rrethkilogramësh. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 196).

**sahatkulla:** ...si minare të xhamive, si sahatkulla. (Bijtë I, 2010, f. 387).

**sipërparaqitura:** Për të gjitha arsyet e sipërparaqitura propozoj. (Bijtë I, 2010, f. 361).

**stërkequr:** Njerëzit e sotëm e kanë stërkequr tepër shijen. (Bijtë I, 2010, f. 106).

**stërngopur:** Jam i stërngopur me rok dhe rep. (Bijtë I, 2010, f. 86).

**superstradave:** ...punësuarve; me ndërtimin e superstradave dhe të rrugëve. (Bijtë I, 2010, f. 454).

**shqiptare-turke-iraniane.**

**shumëfytyrësh:** shqiptar ishin dyfytyrësh, shumëfytyrësh, farisenj. (Bijtë I, 2010, f. 371).

**shumëgjuhësor:** Gjeniu shumëgjuhësor. (Bijtë I, 2010, f. 105).

**shumëkend:** ...vazhdoi me trazira që shumëkend e lanë pa. (Një dashuri, 2003, f. 64).

**shumëkontinentale:** (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 475).

**shumëkujt:** *Shumëkujt mund t'i shkojë.* (Bijtë I, 2010, f. 221).

**shumëndryshme:** kurse fytyrat/janë të shumëndryshme, prandaj. (Bijtë I, 2010, f. 327).

**shumëpartiake:** (Bijtë I, 2010, f. 379).

**shumëvëllimshme:** janë të shumëvëllimshme. (Bijtë I, 2010, f. 35).

**vendzbulimeve:** të kështjellave, të vendzbulimeve arkeologjike. (Qosja, *Bijtë II*, 2010, f. 69).

**vitlindja:** ...mendonte, ishte vitlindja e kryetarit. (Bijtë I, 2010, f. 69).

**zanatlinjve:** I punëtorëve. I zanatlinjve. Ishte një. (Bijtë I, 2010, f. 397).

**zëkëqijtë:** Disa nga zëkëqijtë e Kurnajës. (Bijtë I, 2010, f. 74).

Shembujt e dhënë me një kujdes të shtuar mund të modifikohen e kuptimësohen dhe të bëhen pjesë e sistemit gjuhësor të shqipes, mirëpo kemi mundësi reale edhe për t'i përjashtuar ndonjë rast apo shembull, i cili nuk ka mundësi për t'iu përshtatet paradigmave të shqipes. Kjo mbetet në digresionin e studiuesve të semantiko-leksikologjisë e të morfologjisë. Vepra letrare e Rexhep Qosjes zbulon qartë raportin që ka ai ndaj botës e ndaj gjuhës; ky raport është krijues e i ndërtuar mbi parimin e lirisë së gjerë krijuese, prandaj mund të flitet për krijimtarinë e tij artistike dhe për krijimtarinë e tij gjuhësore. Rexhep Qosja nuk na sjell vetëm botën e njohur dhe nuk shfrytëzon vetëm gjuhën e gatshme: ai krijon botë dhe krijon gjuhë, në të vërtetë duke krijuar gjuhën, krijon edhe botën e veprës së tij dhe anasjellas, prandaj analiza e veprës letrare duhet të shoqërohet edhe nga analiza gjuhësore-stilistike, sepse analiza e shprehjes gjuhësore nuk është e vlefshme pa analizën e përmbajtjes dhe anasjellas. Kjo mënyrë e trajtimit të një vepre letrare është e rëndësishme si pikënisje për të kuptuar statusin e veçantë të stilit funksional të romanit "*Bijtë e askujt*" dhe raportin e tij me gjuhën standarde. Siç na është e njohur, stili funksional ka normën e vet që nis sidomos nga nevojat e veçanta shprehëse në praktikën ligjërimore; këtë e di mirë autori i saj, Rexhep Qosja. I kuptuar kështu, stili funksional parakupton jo mungesë norme, por normën e brendshme gjuhësore, në të vërtetë përzgjedhjen e veçantë brenda vetë gjuhës dhe, rrjedhimisht, brenda normës gjuhësore. Prandaj mund të themi se gjuha e këtij romani është shqipja standarde me kufij të gjerë lirie (Sh. Islamaj).

## Përfundim

Kompozitat e prezantuara janë fjalë të reja, të cilat nuk ekzistojnë në fjalorët ekzistues (mirëpo edhe nëse do të jenë ekzistuese, ato mund të kenë variante polisemike, homonimike, sinonimike, të cilat e pasurojnë leksikun e shqipes), andaj analiza e këtyre kompozitave do të mundësojë krijimin dhe pasurimin e fjalorit të shqipes. Kjo argumentohet për dy arsye pozitive: E parë, me qindra kompozita janë të evidencuar në FESh, i cili ka rreth 41.000 fjalë, *të cilat gjenden ose pjesërisht nuk gjenden në FGjSSh* dhe e dyta, të gjitha fjalët e parme që janë risimtari për kulturën dhe fjalorët e shqipes mund t'i konsiderojmë të mirëpritura. Kjo e fundit ka lidhje të ngushtë me atë të parën, sepse siç dihet kompozitat përbëhen prej dy ose me shumë fjalë kuptimore, të cilat, pas bashkimit në një fjalë të vetme mund ta pasurojnë edhe me shumë fjalorin shpjegues të gjuhës.

Si përfundim mund të themi, gjitha fjalët që i përdorë shoqëria dhe që kanë zënë vend në paradigmat e shqipes, por që nuk e rrezikojnë brumin e saj, për mendimin tim mund të pranohen dhe të sistemohen në fjalorin shpjegues. Të gjitha kompozitat e cituara në këtë studim janë krahasuar me fjalorët ekzistues, mirëpo si të tilla, me kuptimësinë e përdorimit nuk ekzistojnë, prandaj janë risi për gjuhën dhe shqipja mund të pasurohet përmes fjalëformimeve të tilla, kështu që për mendimin tim është një e arritur e mirë, solide dhe e mirëpritur për shqipen e shkruar.

## Referencat

- [1]. Bajçinca, Isa: “Kompozitat dhe terminologjia shkencore”, *Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi*, Prishtinë, 1988.
- [2]. Bardhi, Frang: *Fjalor Latinisht – shqip 1635*, Prishtinë, 1983.
- [3]. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980.
- [4]. *Fjalor i termave të Gjuhësisë*, botuar nga “Akademia e Shkencës e RPSH- Instituti i Gjuhës dhe letërsisë, Seksioni i Terminologjisë”, Tiranë 1975.
- [5]. *Fjalor- Për Pastrinë e gjuhës shqipe*, botuar nga “Akademia e Shkencës e RPSH- Instituti i Gjuhës dhe letërsisë” Tiranë, 1998.
- [6]. *Fjalor Shqip-greqisht*, (hartuar nga K. Kristoforidhi), i transkriptuar nga A. Xhuvani, Tiranë, 1961.
- [7]. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, “Rilindja”, Prishtinë, 1983.
- [8]. *Fjalori elektronik shpjegues* (QEP).
- [9]. *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1981.
- [10]. *Grup autoresh, Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2*, Tiranë, 2002.
- [11]. Halimi, Mehmet: *Çështje fjalëlormimi në gjuhën shqipe*, “Etruria”, Prishtinë, 1996.
- [12]. Ismajli, Shëfkije: *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, “Ramiz Sadiku”, Prishtinë, 1985.
- [13]. Jokl, Norbert: “*Naim be Frashëri e pasunimi i gjuhës shqipe*”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave filologjike II, 1972, Prishtinë, 1974.
- [14]. Kristoforidhi, Konstandin: *Fjalor Shqip-Greqisht*, Prishtinë, 1977.
- [15]. Language Teacher 1998, *Fjalor elektronik shqip-anglisht dhe anasjelltas*.
- [16]. Millaku, Shkelqim: *Kërkime gjuhësore 3*, Prishtinë, 2024.
- [17]. Millaku, Shkelqim: *Kërkime gjuhësore 2*, Prishtinë, 2019.
- [18]. Millaku, Shkelqim: *Kërkime gjuhësore*, Prizren, 2015.
- [19]. Millaku, Shkelqim: *Strukturat sintaksore*, Prishtinë, 2011.
- [20]. Millaku, Shkelqim: *Studime gjuhësore 1*, Prishtinë, 2024.
- [21]. Millaku, Shkelqim: *Studime gjuhësore I (Kompozitat)*, Prishtinë, 2011.
- [22]. Millaku, Shkelqim: *Shqipja e sotme dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera*, Prishtinë, 2019.
- [23]. Millaku, Shkelqim: *Tekst ushtrimesh për lakimin e emrave dhe zgjedhimin e foljeve*, Prishtinë, 2017.
- [24]. Qesku, Pavli: *Fjalor Anglisht-Shqip, English-Albanian Dictionary*, Tiranë, 2002, f. 372.
- [25]. Qiriazati, Kosta: *Fjalor latinisht – shqip*, Tiranë, 1996.
- [26]. Qosja, Rexhep: *Bijtë e askujt 1, 2*, Prishtinë, 2010.
- [27]. Stefanllari, Ilo: *Fjalor Ang.-Shq. dhe shq-ang.*, Tiranë, 2002.
- [28]. *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, “Mihal Duri”Tiranë, 1972.
- [29]. *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972.
- [30]. *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*, Tiranë, 1989.
- [31]. Shuteriqi, Dhimitër: “Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzikut (879-1553)” *Gjurmime albanologjike-seria filologjike*, 19-1989.
- [32]. Thomaj, Jani: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974.
- [33]. Xhuvani, Aleksander: *Për pastrinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1968.
- [34]. Xhuvani, Aleksander: *Vepra Gjuhësore I*, “Mihal Duri”, Tiranë, 1980.
- [35]. Xhuvani, Aleksander: *Vepra Gjuhësore II*, “Mihal Duri”, Tiranë, 1990.